


AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

I JANAR 2023 I

Dogana në shifra

Performanca e Administratës Doganore për muajin Janar 2023 ka qënë në shumë e mirë.
Të ardhurat për muajin Janar 2023 u realizuan në vlerën 14,8 mld lekë ose 102%, rreth 300 mln lekë me shumë se plani.
Krahasuar me Janarin 2022 janë realizuar me shume rreth 40 ton cigare, 650 ton birrë dhe e njehta sasi karburanti krahasuar me një vit me pare.



Dogana Online

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të dixhitalizuar shërbimet online për qytetarët dhe bizneset nëpërmjet platformës E- albania .
Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtime të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Këto shërbime kanë krijuar lehtësira për biznesin dhe qytetarët nëpërmjet ofrimit të shërbimit në kohë dhe me cilësi, duke shmangur vonesat dhe burokracitë e panevojshme.
Vetëm gjatë muajit Dhjetor nga DPD janë miratuar 607 shërbime Online, ndërkohë që janë në proces 200 aplikime.

DOGANA DIGJITALE



Bashkëpunimi me homologët

Ambasadori Alastair King-Smith u prit në një takim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, së bashku me Agjencinë Britanike të të Ardhurave dhe Doganës (HMRC) dhe Operacionet Ndërkombëtare të Ministrisë së Brendshme britanike (HOIO) ku diskutuan mbi bashkëpunimin e suksesshëm mes këtyre tre institucioneve në luftën kundër kimit të organizuar.
Në përputhje me Komunikatën e Përbashkët mes Kryeministrave të Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë në dhjetor, HMRC dhe HOIO do të vijojnë të punojnë ngushtësisht me Dogana Shqiptare për të luftuar kontrabandën dhe financimet e paligjshme.



Aktivite

26 Janar, Dita Ndërkombëtare të Doganave

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Doganave, Administrata Doganore Shqiptare zhvilloi një ceremoni, ku në emër të OBD vlerësoi me "Certifikata Merite", disa punonjës për rritje të cilësisë në ofrimin e shërbimeve doganore ndaj biznesit dhe qytetarëve.
Tradicionalisht, për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Doganave çdo vit, Sekretariati i OBD-së i kushton një temë që është e rëndësishme për sfidat me të cilat ballafaqohet bashkësia doganore globale.
Tematika e WCO për vitin 2023 është "Edukimi i brezit të ardhshëm: promovimi i kulturës së ndarjes së njohurive dhe krenarisë profesionale ne Dogana". Administrata Doganore gjatë këtyre viteve ka patur një transformimin rrënjësor, ku biznesit i shërbehet në çdo kohë, shpejt, pa burokraci dhe me standarde bashkëkohore.



Vizita pune në të gjitha Degët Doganore

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi takime pune me strukturat e Degëve Doganore, ku kërkoi drejtim të shtuar të çdo doganieri, duke patur parasysh që Administrata Doganore ka një rol të rëndësishëm në lëvizjen lirë të njerëzve dhe mallrave.
Gjithashtu Gazheli e vuri theksin te shërbimi me cilësi dhe standarde për çdo qytetar apo biznes.



Deklarime të thjeshtuara (të paplota):

Info-A e dini se?

Operatori ekonomik autorizohet të kryejë procedurat e zhdoganimit të mallrave duke depozituar një deklaratë të paplotë dhe më pas (brënda një periudhe të përcaktuar) të depozitojë deklaratën plotësuese për këto mallra. Deklarata e paplotë nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara apo nuk shoqërohet nga të gjitha dokumentet e nevojshme për atë procedurë doganore.
Deklarimet duhet të paraqiten në rrugë elektronike në mënyrë që të kryhen analiza risku.
Kushtëzohet nga sigurimi i një garancie për detyrimet e importit dhe pagesat e tjera;